



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"

DREJTORIA E SHËRBIMEVE NDIHMËS AKADEMIKE-ADMINISTRATIVE

Gjirokastër, më 06./11./2020

**NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE**

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër, në mbështetje të neneve 57, 62 dhe 64 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" shpall konkursin për personel akademik me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar për viti akademik 2020-2021 si dhe kriteret përkatëse sipas fakulteteve.

**FAKULTETI I EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE**

**Njësia Bazë e Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies**, propozon 9 (nëntë) personel akademik me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar. Kriteret që duhet të plotesojnë kandidatet janë si më poshtë:

- a) Të ketë përfunduar studimet e larta në fushën "Psikologji", "Pedagogji", "Logopedi", "Mësues i Arsimit Fillor", në sistemin me kohë të plotë studimi.
- b) Të kenë përfunduar studimet "Master i Shkencave" në fushën "Mësues i Arsimit Fillor", "Logopedi" ose fushën "Pedagogji-psikologji".
- c) Të ketë përvojë si mentor në praktikat pedagogjike të ushtruara me marrëveshje midis ZA Gjirokastër dhe Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër.
- d) Të kenë notë mesatare të përgjithshme jo më pak se 8 (tetë).
- e) Të kenë përvojë në mësimdhënie më shumë se 3(tre) vjet.
- f) Të kenë përvojë në mësimdhënie në Arsimin e Lartë.
- g) Të kenë njohuri të mira në një gjuhë perëndimore, preferohet gjuha angleze.
- h) Të kenë aktivitet botues në revista shkencore të njohura zyrtarisht, ose materiale shkencore në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.
- i) Të kenë aftësi të mira komunikuese të punës në grup.
- j) Preferohen kandidatët që kanë gradë shkencore, tituj akademikë.

**Njësia Bazë e Gjuhëve të Huaja**, propozon 4 (katër) personel akademik me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar. Kriteret që duhet të plotesojnë kandidatet janë si më poshtë:

- a) Të kenë përfunduar studimet e larta në fushën e Gjuhës angleze, në sistemin me kohë të plotë studimi.
- b) Të kenë notë mesatare të përgjithshme jo më pak se 8 (tetë).

- c) Të kenë përfunduar studimet "Master i Shkencave" në fushën e Gjuhësisë ose Letërsisë, me notë mesatare jo më pak se 8 (tetë).
- d) Të kenë përvojë në mësimdhënie mbi 3 (tre) vjet.
- e) Të kenë gradën shkencore "Doktor i Shkencave" në fushën e Gjuhësisë ose Letërsisë ose të jenë në proces.
- f) Preferohen kandidatët që kanë gradë shkencore, tituj akademikë.

**Njësia Bazë e Historisë dhe Gjeografisë**, propozon 8 (tetë) personel akademik me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar. Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatet janë si më poshtë:

- a) Të kenë përfunduar studimet e larta në degën Histori / Gjeografi, brenda ose jashtë vendit, në sistemin me kohë të plotë.
- b) Të kenë notë mesatare të përgjithshme dhe të specialitetit, jo më pak se 8 (tetë).
- c) Të kenë përfunduar studimet "Master i Shkencave", në Histori / Gjeografi, me notë mesatare jo më pak se 8 (tetë).
- d) Të kenë gradën shkencore "Doktor i Shkencave" në fushën e Historisë / Gjeografisë ose të jenë në proces.
- e) Të kenë njohuri të mira në gjuhën angleze, me dëshminë përkatëse.
- f) Të kenë aftësi të mira komunikuese ose të punës në grup.
- g) Të kenë aktivitet botues në revista shkencore të njohura zyrtarisht ose material shkencor në konferenca kombëtare e ndërkombëtare.
- h) Preferohen kandidatët që kanë gradë shkencore, tituj akademikë.

**Njësia Bazë e Gjuhës dhe Qytetërimit Grek**, propozon 2 (dy) personel akademik me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar. Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatet janë si më poshtë:

- a) Të kenë minimalisht diplomë Master i shkencave ose diplomë të ekuivalentuar master i shkencave në profile të pedagogjisë, të letërsisë dhe lëndë shoqërore të përgjithshme, në gjuhën greke.
- b) Të kenë diplomë universitare në gjuhë, letërsi dhe qytetërim grek ose në lëndë të përafërta me to.
- c) Të kenë përvojë pune mësimdhënëse universitare mbi 2 (dy) vjet.
- d) Të kenë notë mesatare të lëndëve të specialitetit mbi 7 (shtatë).
- e) Të kenë pjesëmarrje në punë shkencore ose kontribute të tjera në fushën e arsimit.
- f) Preferohen kandidatët që kanë gradë shkencore, tituj akademikë.

### **FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS**

Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës

1 (një) vend i lirë në Matematikë

4 (katër) vende të lira në Informatikë

**Të interesuarit për pozicionet e mësipërme duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:**

1. Të ketë diplomë të ciklit të parë (Bachelor) dhe të ciklit të dytë (Master i Shkencave) ose diplomë ekuivalente me to në fushat e Matematikës, Informatikës, Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit ose të përafërt me lëndët që do të lektohen sipas fushës së Departamentit, në sistemin me kohë të plotë.
2. Në rast se i interesuari zotëron një diplomë të tillë, të marrë në universitete të huaja, kërkohet që të jetë e ekuivalentuar në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
3. Për ciklet e studimeve nota mesatare të jetë:
  - a. Për ciklin e parë të studimeve (Bachelor) nota mesatare të jetë 7 e sipër.
  - b. Për ciklin e dytë të studimeve (Master i Shkencave) nota mesatare të jetë 7.5 e sipër.
  - c. Për sistemin e vjetër të studimeve nota mesatare të jetë 7 e sipër.
4. Të zotërojë një gjuhë të huaj të Bashkimit Europian sipas testeve të njohura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
5. Preferohen kandidatët me botime shkencore në revista kombëtare e ndërkombëtare dhe kualifikime të ndryshme pasuniversitare.
6. Preferohen ata që kanë përvojë mësidhënie universitare

#### **Njësia Bazë / Departamenti Biologji –Kimi:**

3(tre) vende të lira në Kimi

1(nje) vend i lire në Biologji.

#### **Të interesuarit për pozicionet e mësipërme duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:**

1. Të kenë diplomën e ciklit të parë (Bachelor) dhe të ciklit të dytë (Master i Shkencave) ose diploma ekuivalente me to, të fituara në Universitetin e Tiranës ose jashtë shtetit në fushën e Kimisë dhe Biologjisë ose të përafërt me lëndët që do të lektohen sipas fushës së departamentit, në sistemin me kohë të plotë.
2. Për ciklet e studimeve nota mesatare të jetë.
3. Për ciklin e parë të studimeve (Bachelor) dhe për ciklin e dytë të studimeve (Master i shkencave) nota mesatare të jetë 8 e sipër.
4. Për sistemin e vjetër të studimeve nota mesatare të jetë 8 e sipër.
5. Në rast se i interesuari zotëron një diplomë të tillë, të marrë në universitete të huaja, kërkohet që kjo të jetë e ekuivalentuar në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë.
6. Të zotërojë një gjuhë të huaj të B.E, sipas testeve të njohura nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë.
7. Preferohen kandidatët me botime shkencore në revista kombëtare e ndërkombëtare dhe kualifikime të ndryshme pasuniversitare
8. Preferohen kandidatët që kanë përvojë në mësimdhënie universitare.

#### **Njësia Bazë / Departamenti Infermierisë 20 (njëzetë) vende të lira pune**

Të interesuarit për pozicionet e mësipërme duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Të kenë mbaruar studimet universitare me kohë të plotë në universitetet publike ose jashtë shtetit pranë Fakultetit të Mjekësisë, Dega Mjekësi e Përgjithshme. Kanë përparësi kandidatët që kanë mbaruar specializime, në përshtatje me lëndët që do të zhvillojnë.
2. Në rast se kandidati zotëron një diplomë të tillë, të marrë në universitete të huaja, kërkohet që të jetë e ekuivalentuar në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
3. Nota mesatare e studimeve universitare per mjeket te jete 7.5 e siper. Ky eshte kriter skualifikues.
4. Të kenë mbaruar studimet universitare në Infermieri e Përgjithshme ose Mami me kohë të plotë në universitetet publike. Kanë përparësi infermieret që punojnë në Spitalin e Gjirokastres (kryesisht kryeinfermieret), ku studentet kryejnë praktiken profesionale.
5. Nota mesatare e studimeve universitare për infermierët të jete 7 e sipër.
6. Kanë prioritet kandidatët që zotërojnë një gjuhë të huaj të Bashkimit Europian sipas testeve të njohura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
7. Preferohen kandidatët që kanë eksperiencë pune në klinikë dhe në mësimdhënie universitare.
8. Kanë përparësi kandidatët që kanë botime shkencore.
9. Kanë përparësi kandidatët me tituj dhe grada shkencore.
10. Preferohen kandidatët me kualifikimet e ndryshme pas universitare

## **FAKULTETI EKONOMIK**

Departamenti i Kontabilitet-Financës

6 (gjashtë) persona, 5 (pese) në fushën e Ekonomisë dhe 1 në fushën e Drejtësisë;

Departamenti i Administrimit Publik

4 (katër) persona, 3 (tre) në fushën e Ekonomisë dhe 1 (nje) në fushën e Drejtësisë;

Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit

3 (tre) persona, (dy) persona në fushën e Ekonomisë dhe dhe 1 (nje) në fushën e Drejtësisë.

Gjithashtu, ju propozojmë që kriteret e vlerësimit të kandidatëve që konkurojnë për personel akademik me kohë të pjesshme në njësitë bazë të FE, të jenë si më poshtë:

1. Të kenë përfunduar studimet universitare të ciklit të parë "Bachelor" në fushën e Ekonomisë apo Drejtësisë, në sistemin me kohë të plotë (brenda apo jashtë vendit).
2. Të kenë diplomën "Master i Shkencave" ose diploma ekuivalente me të në fushën e Ekonomisë apo Drejtësisë (fituar brenda apo jashtë vendit).
3. Preferohen të kenë përvojë në mësimdhënie në arsimin e lartë.
4. Të kenë njohuri të gjuhëve perëndimore (anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht, spanjisht) e vërtetuar me dëshmi.
5. Preferohen të kenë botime në revista shkencore dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare të vërtetuara me dëshmitë përkatëse.
6. Të kenë aftësi të mira komunikuese e të punuarit në grup.

**Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët që konkurojnë:**

1. Kërkesë me shkrim;
2. Jetëshkrim sipas formatit standard (europass);
3. Fotokopje të letërnjoftimit (ID).
4. Kopje të diplomës Master Shkencor dhe Bachelor dhe të listës së notave përkatëse (të noteruara). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të dorëzohet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
5. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë të noteruar);
6. Vërtetim të gjëndjes shëndetësore (Raport mjekësor për aftësitë në punë);
7. Vërtetim i gjëndjes gjyqësore, vetë deklaram sipas formës së kërkuar nga ligji;
8. Dokumentacion nga Institucioni ku ka punuar që nuk është marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera në jetëshkrimin tuaj;
10. Dëshmi penaliteti
11. Çdo dokument tjetër i noterizuar që është kërkuar më sipër (në kriteret për kualifikim) apo jo vetëm.

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën. Mosparaqitja e plotë e dokumentave, sjell s'kualifikim të kandidatit. Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë dosjet e kandidatëve. Konkursi do të zhvillohet në Rektoratin e UGJ-së. Dokumentat e mësipërm të noterizuar, të 3 (tre) muajve të fundit dhe dorëzohen pranë Drejtorisë së Shërbimeve Ndhmës Akademike-Administrative në Universitetin "Eqrem Çabej" të shoqëruara me inventar.

**Afati i fundit i pritjes së aplikimeve është brenda 5 ditë pune nga dita e nesërme publikimit të njoftimit.**

**REKTOR**  
**Prof. Dr Bektash MEMA**